

AKT THEMELIMI I SHOQËRISË ME PËRGJËGJËSI TË KUFIZUAR
“ SA4 DEVELOPMENT “ shpk

Në Tiranë, sot më datë 01.09.2025, te poshtëshënuarit:

- 1- Z. Lorin Çekrezi, shtetas shqiptar lindur 26.01.1989 lindur në Tiranë dhe banues në Tiranë, mbajtes i Letërnjoftimit ID, me numër personal I90126057L
- 2- Z. Rezart Struga shtetas shqiptar lindur 27.04.1988 lindur në Tiranë dhe banues në Tiranë, mbajtes i Letërnjoftimit ID, me numër personal I80427073G
- 3- Z. Klaudio Cari shtetas shqiptar lindur 14.10.1987 lindur në Tiranë dhe banues në Tiranë, mbajtes i Letërnjoftimit ID, me numër personal I71014034C

me cilësinë e “ortakëve themelues” deklarojmë se me vullnet të lirë të plotë, mbeshtetur në ligjin Nr.9901 datë 14.04.2008, “ Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” i ndryshuar, ligjin Nr. 9723, datë 3.5.2007 “ Për Regjistrimin e Biznesit“, i ndryshuar, krijojmë shoqërinë tregtare me përgjegjësi të kufizuar, “SA4 DEVELOPMENT “ shpk,

Neni 1
Emri, Forma

Shoqëria do të ketë emrin ‘SA4 DEVELOPMENT’, dhe formë ligjore: “Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar” (më poshtë e quajtur “Shoqëria”).

Neni 2
Personaliteti juridik

Shoqëria fiton personalitetin juridik, pasi të jetë regjistruar në QKB, në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj.


Neni 3
Selia

Shoqëria e ka seline në adresë: Rr.Besim Imami nr.34, kati perdhe njesia administrative nr 10 Tiranë .

Neni 4
Objekti i veprimtarisë

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë do të jetë:

Ndertimi i objekteve civile apo industriale dhe menaxhimi i zbatimit te projekteve te kesaj natyre per vete dhe per te trete. Investimin në projekte zhvillimi zonash urabane, turistike apo rezidenciale apo investime të cilësdo natyre qoftë në zhvillimin e pasurive të paluajtshme në përgjithësi. Shitja



e njësive të gjeneruara nga investimet në projekte të zhvillimi të pasurive të paluajtshme apo shitja e projekteve të zhvillimit në veçanti. Administrimi dhe shfrytëzimi I njësive të gjeneruara nga investimet në projekte e zhvillimit në zonat e turizmit për qëllime rekreative, restorative dhe akomoduese. Kryerjen e aktivitetit të menaxhimit të riskut dhe shërbimeve këshillimore të sigurisë dhe shëndetit në punë Vleresim të pasurive të paluajtshme. Administrimin e ambienteve të përbashketa (në bashkepronësi)ne ndertesat e banimit ,objekteve civile etj . Tregtim me pakice e shumice të mallrave të ndryshme të lendeve të para të ndertimit dhe prodhimeve. Tregtim dhe prodhim të materialeve të ndertimit. Projektim, Mbikqyrje dhe Kolaudimi si dhe ofrimi I shërbimeve dhe konsulencave profesionale lidhur me fushat perkatese.Projektime dhe zbatime të ndertime civile, industriale, turistike, bujqesore. Projektime dhe zbatime interieresh.Studime, planifikime, vleresime dhe projektime dhe zbatime urbanistike Projektime dhe zbatime peisazhi dhe sistemimi. Studime dhe projektime dhe zbatime produktesh; Studime, projektime , dizenjime dhe zbatime për market.Studime , projektime dhe zbatime të inxhinierise së ndertimit, inxhinierise elektrike dhe inxhinierise hidromekanike. Projektime konstruktive dhe supervizim punimesh Studime e projektime dhe zbatime hidrogeologjike dhe gjeologjike; Projektim dhe zbatime fotogrametrik, hartografik, topografik; Studime fizibiliteti;Projektime dhe zbatime rrugeshe, urash, porte turistike;Projektime dhe zbatime linjash dhe sistemesh së prodhimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike, projektim ujësjelles, kanalizime, vepra ujëtie, kullimi, impiante vaditese, diga, etj; Restaurime dhe konsulencia për shërbimet e më sipërme; Tregetim mallrash brenda dhe jashtë vendit; Gjithashtu, Shoqëria mund të kryejë çdo lloj veprimtarie apo transaksion tjetër që lidhet me pasuri të luajtshme e të paluajtshme, me kryerjen e veprimeve tregtare, industriale, bankare dhe/ose financiare të çfarëdo lloji dhe natyre, të nevojshme ose të dobishme për arritjen dhe ose plotësimin e objektivit të Shoqërisë, që nuk ndryshon aktivitetin parësor të Shoqërisë dhe nuk bie në kundërshtim me legjislacionin shqiptar në fuqi.

Neni 5
Kohëzgjatja

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj pa afat.


Neni 6
Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i nënshkruar dhe i shlyer i shoqërisë është 100.000 Leke, i ndarë në një kuotë, i cili zotërohet si më poshtë:

Z. Klaudio Cari, zotëron 1 kuotë me vlerë 34.000 Leke (tridhjetëkater mijë Leke), e cila përbën 34 % të kapitalit të shoqërisë

Z. Lorin Çekrezi, zotëron 1 kuotë me vlerë 33.000 Leke (tridhjetetë mijë Leke), e cila përbën 33 % të kapitalit të shoqërisë

Z.Rezart Struga, zotëron 1 kuotë me vlerë 33.000 Leke (tridhjetetë mijë Leke), e cila përbën 33 % të kapitalit të shoqërisë



Kontributi i ortakëve është në para.

Ortakët nuk përgjigjen për detyrimet e shoqërisë tregtare dhe mbulojnë personalisht humbjet e shoqërisë deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkruara.

Neni 7
Transferimi i kapitalit

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;
- d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim.

Personi që kalon kuotën dhe ai që e fiton atë përgjigjen në mënyrë solidare ndaj shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotës, nga çasti i kalimit të kuotave, deri në çastin e regjistrimit të kalimit të saj ne Qendren Kombëtare të Biznesit, sipas nenit 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit”.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

Neni 8
Organi Vendimmarrës

Asambleja e Ortakëve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë, për çështjet e mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat “c” dhe “ç” të kësaj pike;
- dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- i) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

Vendimet e paregjistruara në regjistrin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme. Shoqëria nuk



mund t'i kundrejtojë pavlefshmërinë të tretit, që ka fituar të drejta në mirëbesim, përveç rastit kur shoqëria provon se i tretë ka pasur dijeni për pavlefshmërinë, apo në bazë të rrethanave të qarta nuk mund të mos kishte pasur dijeni për të.

Neni 9
Administrimi

Administratorë i shoqërisë është:

- 1- Z. Klaudio Cari shtetas shqiptar lindur 14.10.1987 lindur në Tirane dhe banues në Tirane, mbajtes i Letërnjoftimit ID, me numër personal I71014034C, emëruar ne këtë detyrë për një afat 5 vjeçar me të drejtë ripërtëritje.

Neni 10
Baza Ligjore

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me këtë akt themelimi dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Për sa nuk parashikohet ne kete akt themelimi, do te zbatohen dispozitat e ligjit "Per tregtare dhe shoqerite tregtare", Kodit Civil dhe çfaredo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

Neni 11
Dispozita perfundimtare

Ky akt themelimi u redaktua ne 4 kopje, në gjuhën shqipe, me përmbajtje dhe vlera te njëjta juridike.

Akti i mësipërm pasi miratohet në parim dhe nen per nen nga Ortakët themelues të shoqërisë tregtare "SA4 DEVELOPMENT " shpk , nënshkruhet në të gjitha kopjet duke vendosur emrin, mbiemrin dhe firmen orgjinale.

ORTAKËT THEMELUES

Klaudio Cari



Rezart Struga



Lorin Çekreci

